



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KUVENDI KOMUNAL

01 Nr. 23 /24

Më 28.11 /2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d), Ligji Nr.-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Rregullore (QRK) nr:19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, si dhe Stautit të Komunës së Mamushës 01/2008 e datës 01.12.2008, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me datën 29.11.2024 mori këtë

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Përzgjedhës

Neni 1

Formohet Komisioni përzgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në pozitat e Drejtorëve të Institucioneve Edukativo Arsimore që janë në vartësi të Komunës së Mamushës në këtë përbërje:

1.1 Erol Morina- DKA (Kryesues)

1.2 Nazmi Morina- Këshill I Prinërve

Vëzhgues

1.1 Suna Morina- Prind

1.2 Buyar Mazrek Mësimdhënës

Pjesë përbërëse e këtij komisioni do të jetë edhe një anëtar I caktuar nga MASHT.

Neni 2

Detyrë e këtij Komisioni përzgjedhës është që të bëjë intervistimin dhe vlerësimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në Konkursin për pozita Drejtor dhe në bazë të pikëve të fituara, bën ranglistën e kandidatëve më të suksesshëm dhe ia propozon Kryetarit të Komunës për emërimin në pozitën Drejtor të shkollës sipas Konkursit

Neni 3

Kompetente për zbatimin e këtij vendimi është Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi me Miratimin e Kuvendit Komunal, Shqyrtim dhe Miratim nga ana e MAPL, dhe pas publikimit në Wep faqen e Komunës së Mamushës

